



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM Nr. 34 datë 18.07.2011

PËR MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE DHE SHPËRNDARJEN E  
REZULTATIT FINANCIAR TË VITIT 2010 TË SH.A "UJËSJELLËS  
KANALIZIME" KORÇË

Këshilli Bashkiak në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Neni 135, pika 2 gërma dh, gërma e, si dhe të Statutit të Sh.A UKKO Neni 10/dh/ e, pasi u njoh me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Nr. 3 mb 11/01 datë 14.04.2011 dhe pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të pasqyrave financiare dhe shpërndarjes së rezultatit financiar të vitit 2010, dërguar me shkresë nga Drejtoria e Sh.A UKKO,

VENDOSI

1. Të miratojë pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e rezultatit të Shoqërisë për vitin 2010.

Fitimi i ushtrimit	6.769.565 lekë
Rezervë ligjore 5%	338.478 lekë
Rezervë zhvillimi 85%	5.754.130 lekë
Dividenti	676.957 lekë
Divident Bashkia Korçë	609.261 lekë
Tatim 10 % mbi Dividentin	67.696 lekë

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ILIRIAN PENDAVINJI